



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:225431

Datë: 10.06.2022

Numri i dokumentit: 03117188

PKR.nr.148/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Krimeve të Rënda, trupit gjykues i përbërë nga gjyqtarët **Drilon Haraçia** - Kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve profesional – **Shaqir Zika dhe Ilir Rashkaj** - anëtarë të trupit gjykues, me zyrtares ligjore Arbënore Basha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. (T.) K. nga fsh.M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelor në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda me numër PP/I.nr.202/21, të datës 12.10.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor - publik me datën 12.05.2022 dhe me dt.06.06.2022, në prezencën e Prokurores së Shtetit Ardita Beqiraj – Hyseni dhe të dëmtuarve B. K. dhe Shpresa Paçarizi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av.Agron Kryeziu nga Malisheva, sipas autorizimit, me dt.09.06.2022, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa e përpiloi **me dt.10.06.2022**, këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

A. K., i biri i T., nënës A., e gjinisë G., i lindur më....., në fshatin M., Komuna e Malishevës, ku edhe tani banon, i martuar, at i 4 fëmijëve, punon si bujk dhe zdrukthëtar, ka të kryer Shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal:.....

Ë S H T Ë F A J T O R

I.Sepse me dt.08.09.2021, në fshatin M. K.Malishevë, përdor armën me qellim kërcënimi dhe frikësimi, të dëmtuarve B. dhe Sh. K. nga fshati T.e poshtme, K. Malishevës e në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari B. K. kishte qenë me veturën e tij së bashku me bashkëshorten, kunatën dhe mbesën e tij dy vjeçare me të arritur tek plantacioni i arrave në vendin e lartcekur i pandehuri A. duke sinjalizuar me një dritë elektriku në drejtim tyre sapo ndalet i dëmtuari, pandehuri afrohet tek xhami i veturës dhe i kishte thënë “pse po vozitë 100km/h”, i dëmtuari ia kishte kthyer se ‘rruga është e paasfaltuar dhe nuk ka mundësi me vozitë aq shpejtë sa thua ti” dhe i pandehuri

i nevrkosur i drejtohet me fjalët tani të tregoj unë se sa je duke vozitur, e shan me nënë dhe me dorën e djathtë nga brezi nxjerr pistoletën Loger, model HS9 9mm, me numër serik H139797, prodhim kroat, kalibër 9mm, ku i dëmtuari sapo e vëren me shpejtësi e nis veturën dhe dëgjon duke shtënë me armë disa herë të pandehurin duke shkaktuar frikë dhe ankth tek të dëmtuarit.

- **Me çka ka kryer veprën penale, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së.**

II. Sepse nga data e pa vërtetuar deri me datë 17.09.2021, ne fshatin M. K.Malishevë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 Ligjin mbi armët të Republikës së Kosovës, dhe atë armën-pistoletë Loger, model HS9 9mm, me numër serik....., prodhim kroat, kalibër 9mm, dy karikatorë, 22 fishekë kalibër 9x19 me te cilën arme ka kryer veprën e përshkruar si ne piken I te dispozitivit, arma dhe municioni janë konfiskuar nga ana e zyrtarëve policorë.

- **Me çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par. 1, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, dhe neneve 367 par.2 dhe nenit 366 par.1 dhe 3 të KPRK-së, të akuzuarit, ia shpall dënimet si vijon:

- **Për veprën penale nën. I** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Burgim** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumën prej 1200 (njëmijë e dyqind) Euro.
- **Për veprën penale nën. II** të dispozitivit të këtij vendimi me **Dënimin me Gjobë** në shumë prej 800.00 € (tetëqind) Euro.

Andaj gjykata konform nenit 76 të KPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

ME DËNIMIN ME KUSHTË, duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, dhe **ME DENIM UNIK ME GJOBË në shumë prej 2.000.00 € (dymijë) Euro**, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata të akuzuarit ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej **100 (njëqind) ditëve**, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) Euro.

Të dëmtuarit; B. K. dhe Sh. P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Ndaj të akuzuarit konfiskohet: një (1) armë-pistoletë Loger, model HS9 9mm, me numër serik, prodhim kroat, kalibër 9mm, dy karikatorë, 22 fishekë kalibër 9x19, si objekte të veprës penale.

Detyrohet i akuzuari A. K., që ti paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumë prej 100 (njëqind) Euro, si dhe për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Krimeve të Rënda, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.202/21, të datës 12.10.2021, kundër të akuzuarit A. (T.) K. nga fsh.M., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të dt.12.05.2022, Gjykata ia ka aprovuar pranimin e fajësisë për veprën penale sipas pikës II të aktakuzës sa i përket veprës penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke konsideruar se pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimin të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij av.Agron Kryeziu, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës. Ndërsa meqenëse se i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 367 par.2 Gjykata nuk e ka shpall vendimin për veprën penale për të cilën e ka pranuar fajësinë pasi që këtë ka vendosur ta bëjë kur të përfundoj procedura edhe ndaj veprës tjetër për të cilën i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, duke vazhduar procedurën për veprën penale për të cilën nuk e ka pranuar fajësinë.

I akuzuari A. K., gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale sipas pikës I të akuzës sa i përket veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, ndërsa e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me pikën II për të cilën ngarkohet me akuzë dhe atë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së,

Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj - Hyseni në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor në çështjen penale kundërt të akuzuarit A. K. sa i përket veprës penale të parë me qëllim frikësimi ndaj të dëmtarëve këtu B. dhe Sh. K. në tërësi u vërtetua kjo gjendje faktike gjatë deklaratave të dhëna nga të dëmtuarit të cilët, gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor po ashtu në mënyrë të njëjte kanë deklaruar edhe në prokurori të cilët bindshëm dhe kjarët treguan se si pas një shkuarje për të pame gjatë daljes janë sinjalizuar me dritë nga i pandehuri duke vazhduar me sinjalizim deri në momentin kur janë ndalur me automjet, me të ndalur i pandehuri brenda rrethojës së pemishtes së tije duke mos iu hequr dritën nga automjeti, fillimisht iu drejtohet :Se pse po vozisni kaq shpejt, tutje vazhdon me sharje, e më pas nxjerrë armën e tij të cilën në atë vend e posedonte pa autorizim dhe me leje të skaduar e kur të dëmtuarit e vërejnë se i njëjti e ka nxjerre armën i dëmtuari Besim vazhdon ta drejton automjetin me aq sa mundet dhe këtë në shenjë frike dhe shqetësimi. I pandehuri shtënë 2 herë me qëllim frikësimi, se i njëjti ka shtënë pikërisht nga vendi ku të dëmtuarit deklarojnë dhe po ashtu edhe dëshmitarja e cila deklaroi në mënyrë të njëjtë V. K. e cila ishte bashkudhëtare me te, na vërteton raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes ku është dhënë konstatimi se njëra gëzhgjë e kal.9mm, shtënë nga arma e të pandehurit është gjetur brenda plantacionit, larg skajit të rrugës 5 metra, ndërsa gëzhgoja tjetër larg skajit të rrugës 6 metra. Deklarimi i të dëmtarëve dhe i dëshmitares është në përputhje të plotë me provat materiale të cilat u administruan gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndërsa faktin se të njëjtit kanë pësuar ankth dhe frikë nga vërteton raportet mjekësore ku i është dashur që të shkojnë në trajtim mjekësor e dëmtuara dhe dëshmitarja, e nga konstatimi i mjekut është përshkruar rritje e të rrahurave të zemrës dhe shqetësim. Mbrojtja e të pandehurit nuk ka mbështetje në asnjë provë, i njëjti mbrohet në këtë mënyrë për ti ikur përgjegjësisë penale dhe at sa i përket qëllimit se kinse nuk ka gjuajtur për ti frikësuar por që gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor shumë kjarët u vërtetu e kundërta, andaj konsiderojë se në tërësi është vërtetuar se i pandehuri me datën 17.09.2021 ka përdorur armën me qëllim të frikësimit të cilën armë e ka poseduar pa autorizim, gjykatës i propozojë që të pandehurin A. ta shpall fajtor, ta dënojë në bazë të ligjit si dhe ta obligojë në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa para vendosjes lidhur me vendimin mbi llojin dhe lartësinë e dënimit si rrethanë rënduese të ketë mënyrën e kryerjes së kësaj veprë nga ana e tij, si dhe rrezikshmërinë e kësaj veprë, ndërsa rrethana lehtësuese tek i pandehuri nuk janë gjetur.

I dëmtuari B. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit ka shtuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se kërkon kompensim të dëmit.

E dëmtuara Sh. P., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit ka shtuar se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe se kërkon kompensim të dëmit.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. K., avokatit Agron Kryeziu, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë seancave gjyqësore i mbrojturi im edhe deklarimin e tij në polici dhe në prokurori ka pranuar veprën penale nga neni 366 par1 dhe përdorim i armës, ndërsa në asnjë formë nuk ka pranuar se armën ne ka përdorur me qëllim të frikësimit të këtu të dëmtarëve. Kjo

çështje gjatë shqyrtimeve gjyqësore dhe deklarimit të të dëmtarëve me asnjë provë nuk kanë arritur që ta argumentojnë se i mbrojturi im ka shtënë me armë me qëllim të frikësimit të të dëmtarëve. Gjatë seancës së datës 12.05.2022 të dëmtuarit B. K. dhe Sh. K. dhe dëshmitarja V. K. nuk kanë mundur të argumentojnë se i mbrojturi im ka shtënë me armë me qëllim të frikësimit, madje në deklarimet e tyre kanë deklaruar se kanë parë edhe plumbat me xixa, gjë e cila në asnjë formë nga asnjë ekspert dhe nuk mund të ndodhë një gjë e tillë. I mbrojturi im dhe sot e sqarojë rastin se si ka ndodhur dhe pas sa kohe ka shtënë me armë dhe qëllimin e shtënies me armë në ajër. I mbrojturi im nuk ka pasur asnjë arsye, shkas që ta përdor armën me qëllim frikësimi, gjëja të të dëmtarëve, pasi që as i dëmtuari nuk ka ndërmarrë asnjë veprim të sulmit ndaj të mbrojturit tim, i mbrojturi im armën e ka pasur me leje, është trajnuar për përdorimin e saj e sqarojë edhe në këtë seancë për qëllimin e përdorimit të armës, duke i marrë për bazë të gjitha deklarimet e të dëmtuarve të cilat deklarime në polici dhe në prokurori dhe siç është vërtetuar edhe në seancë gjyqësore, qëllim i tyre ka qenë përfitimi material madje për personat të cilët vuajnë nga sëmundjet e epilepsisë e cila u dëshmuar edhe gjatë seancës së datës 12.05.2022. Duke i marrë për bazë të gjitha këto i propozojë gjykatës që të mbrojturin tim ta lirojë nga pika 1 e aktakuzës, përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm me qëllim të frikësimit të të dëmtarëve, ndërsa në seancën fillestare i mbrojturi im e ka pranuar veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprën penal përdorim i armës nga neni 367 par.1 të KPRK-së. Andaj i propozojë gjykatës që të bëjë rikualifikimin e veprës penale që të njëjtin ta shpalli fajtor për veprën penale 367 par. 1 e jo siç pretendon prokuroria 367 par.2 të KPRK-së.

I akuzuari A. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe tjetër nuk kam se çka të shtojë.

2. Provat e administruara gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor

Meqenëse i akuzuari A. K., nuk e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale sipas pikës I të akuzës për të cilën akuzohet (ndërsa ka pranuar fajësinë sipas pikës i të aktakuzës), gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike gjatë shqyrtimit gjyqësor ka bërë dëgjimin e të dëmtuarve në cilësinë e dëshmitarëve B. K. dhe Sh.P. si dhe të dëshmitares V. K. si dhe i ka administruar këto prova materiale si: raportin fillestar me nr.rastiti datës 18.09.2021, raportin e oficerit Blerim Foniqi nr. rastiti datës 18.09.2021, listën e armëve të konfiskuara si dhe lejën e armës së leshur nga MPB-ja me emërtimin leje për armë shenjëtarie me datë të skadimit 07.04.2020 përkatësisht i lejes së veçantë nr. kartelëstë lëshuar nga MPB në emër të A. K., raportin e vendit të ngjarjes të përpiluar nga PK -Njësia për forenzikë të datës 17.09.2021 së bashku me fotoalbumi së bashku me 16 fotografi me ngjyra të përpiluara nga ana e Policisë së Kosovës, dy (2) raportet mjekësore të dëmtuarës Sh. K. të datës 17.09.2021 dhe dëshmitares V. K. i datës 17.09.2021, si dhe ka dëgjuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit A. K.

2.1. Deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve

2.1.1. Dëshmitari **B. K.** gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar se me datën 08.09.2021, rreth orës 19:30 minuta, së bashku me nënën, bashkëshorten dhe kunatën V. kanë shkuar në fshatin M., tek dajhtë për me pa pasi që kanë pasur rast të vdekjes, ndërsa duke u kryer nga e

pamja kah ora 20:05/h, hala pa dal prej dyerve të oborrit të dajës iu është drejtuar një dritë e baterisë, dhe në at moment unë jam lëshuar rrugës teposhtë, ndërsa i akuzuari te pemishtja ku me dyertë e dajës veç rruga i ndan, ka shtuar se ia ka bërë me dritë dhe ai iu ka afruar dhe pse nuk pa mjaftueshëm për shkak të dritës, por kam menduar se është dikush dhe po donë me më pyetje diçka, unë nuk kam qenë duke vozitur shpejtë, por ngadalë pasi që ajo rrugë është shumë e keqe dhe kur jam ndaluar e kam hapur xhamin me fol, ku i akuzuari më ka thënë : Pse po vozitë 100km/h?, dhe unë i thashë se: a je në rregull se unë nuk vozisë 100 km/h, dhe pastaj ai më ka shajhtë me nënë dhe më tha : tash të kallëzojë se sa në orë je duke shkuar, dhe pastaj shoqja me kunatën më thanë ik se nxorri alltinë, ndërsa kur e ka qitur baterinë ndër sjetullë i kam pa fytyrë si figurë dhe jam tërhequr sa më shpejt dhe ky pastaj ka shtënë 3 herë me armë, dhe i kam parë plumbat që kanë kaluar afër kerrit. Kur jemi ndaluar me automjetet i akuzuari ka qenë nga ana e bashkëshortes, as 2 metra nuk ka qenë largësia, ka qenë i mbështetur në mrezhë të plantacionit, ndërsa kur ka shtënë besojë që ka qenë largësia 6-10 metra, ndërsa kur jemi larguar 100 metra e kam këqyr shoqen i kishte rënë të fiktë, ndërsa kunata më tha : ik se është duke ardhur mbrapa dhe deri kur jemi dal në rrugë kryesore e kemi parë se është duke na ndjekur me bateri. A. para rastit nuk e kam njohur, mirëpo e kam kuptuar se i kemi kushërinjtë të largët të dajave dhe nuk kemi pasur kurrë ndonjë konflikt as unë e as familjarët e mi. Pas rastit atë natë deri në 3-4 të natës kemi qenë në polici, dhe në mëngjes më ka ardhur daja me vëllaun e tij duke e arsyetuar se i ka gjuajtur qenët dhe më kanë thënë se shko heke deklaratën në polic dhe nëse dënohet vëllau do të kem punë me ty. Dëshmitari deklaroi se unë nuk e kom pa me sytë e mi duke gjuajtur me armë, vetëm e kom pa armën në dorë dhe zhurmat dhe plumbat të cilat na kanë kaluar afër automjetit. Se ka qenë errësirë dhe dritën ma kishte drejtuar dhe unë nuk e kam parë armën por e di që ka pasur diçka në dorë ndërsa kur kanë bërë titur kunata dhe shoqja unë kam ikur. Po është e vërtetë kjo se dikund përafërsisht 20 metra larg vendit të ngjarjes janë gjetur gëzhojat.2-3 metra maksimumi pasi që unë e kam afruar shumë afër pemës. Po, ndërsa dorën e ka pasur mbi tel me bateri. Se ka qenë 5-10 metra pasi që automjetin e kam pasur në shpejtësinë e parë dhe rruga ka qenë shumë e keqe. Shumë pak kam parë pasi që baterinë e kam pasur në sy por kam dëgjuar dhe momentin kur kanë bërë titur kunata dhe bashkëshortja : Ik, unë kam filluar me ik edhe pse baterinë e kisha të drejtuar dhe e kam parë duke bërë një lëvizje dhe pas 2 sekondave kam dëgjuar të krisurat, ndërsa e tërë ngjarja ka zgjatur 5-10 sekonda. kur ka gjuajtur me armë baterinë e ka pasur ndër sjetulle dhe ka qenë e ndezur. I kam parë si gjigja, ndërsa kur jam larguar rreth 100 metra kur jemi ndal me i dhënë ndihmë shoqes pasi që ishte alivanosur, kunata e ka parë dhe më tha gutu se është duke na ardhur mbrapa, e kam kthyer kryet po ashtu edhe në pasqyrë e kam parë, pastaj e kam parë dritën e baterisë të drejtuar prapa nga ne. lartësia e rrethojave të pemishtes ndoshta është 1 metër e gjysmë. Kur ka gjuajtur i akuzuari a ka qenë mbas telave ka qenë dhe ka qenë i ndalur. Gëzhojat kanë qenë aty ku na ka sulmuar, ndërsa sa i përket 20 metrave unë i kam shpjeguar policisë se këtu duhet të jetë vendi i ngjarjes pasi që ka pasur të mbjell ara shumë kumbulla.

2.1.2. Dëshmitarja **Sh. P.** gjatë shqyrtimit gjyqësorë ka deklaruar : se me datën 17.09.2021 kemi qenë për ngushëllime te dajtë me bashkëshortin dhe kunatën dhe një vajzë 2 vjeçe ndërsa nënën e kemi lënë tek daja, aty kemi ndenjur një gjysmë ore, pasi që dolëm e kemi parë të akuzuarin me dritë shumë poshtë prej pemëve, dhe ne duke dal prej dyerve ky ka filluar me u ngritë tenaltë ndërsa ne ishim duke zbritur teposhtë dhe na bëri me dritë për me u ndal, dhe

ne u ndaluam, kinse po pyete diçka po kërkon ndihmë, ndërsa ai tha se : Kqyr sa jeni duke vozitur, ndërsa Besimi i tha nuk jam duke vozitur 100 km/h pasi që është rruga e keqe, ndërsa i akuzuari i tha se: tani unë të tregoj ty se a je duke vozitur 100 km2, dhe ka filluar duke shajtur tyl farë fjalësh apo si është më keq dhe baterinë nuk e hiqte nga automjeti dhe e ka futur baterin ndër sjetull dhe e ka nxjerrur alltinë, dhe unë kam bërë titur : O B. thash ik se o ka donë me e nxjerrë alltinë, dhe deri sa kemi dalur në rrugën kryesor ky ka hec dhe baterinë nuk e ka ndal, armën e ka nxjerrur nga brezi prapa dhe ka gjuajtur me armë nja 3 herë të një pas njëshme-përnjëherë. Nuk mund ta përshkruaj distancën por ka qenë afër meje pasi që ka qenë në krahun tim të automjetit dhe ka qenë andej telave. Më kujtohet se ai ka gjuajtur pasi kam bërë titur unë : B. ik, ka gjuajtur. Në pyetjen e bërë nga mbrojtësi Në deklaratën tuaj të dhënë në polici në faqen 2/3 rreshti 10/11/12 keni deklaruar se Pastaj burri që na ndalojë fillojë të na shajë dhe fyejë me shprehje të rënda dhe shumë ofenduese e unë meqë isha afër këtij personi (pasi që ishte nga ana ime) e vërejta se ky person po nxjerrë diçka nga brezi, por unë e kuptova se ishte revole. A mundesh me na tregu qysh e kuptove, qysh e pave se ishte revole? Dëshmitarja ka deklaruar.: Po e kam parë pasi që alltin e ka nxjerrur nga krahu i djathtë në anën e majtë dhe ky baterinë e vet e lëshojë teposhtë dhe e pash kur alltin e nxjerri. Po deri në fund të telave ka ardhur duke ngajtur dhe këtë e kam parë pasi që ishte me bateri. Jo deri sa kemi dal në rrugë kryesore kam qenë mirë, baterinë e ka pasur në dorën e djathtë.Pas përshkrimit të distancës në gjykatë konstatohet se dëshmitarja deklaron të jetë 3-4 metra. Kur ka gjuajtur ka qenë në lëvizje automjeti. Po e kam parë pasi që ka qenë në krahun tim në automjet. I kam parë xixat u shishin krahas kerrit si drita, në krahun tim të automjetit anash. Nëpërmjet pëmishtes na ka ndjekur dhe e ka nxjerrë alltin dhe ka gjuajtur me te dikund mbas 5 sekondave pasi që i kam thënë Besimit ik.

2.1.3. Dëshmitarja **V. K.** gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me datën 17.09.2021 së bashku me B. dhe Sh.kemi qenë në mbrëmje tek dajtë e burrit në orën 20:00/h, shkujtëm me pa, kah shkuam mirë shkuam, ndërsa kah u kthyem na ka dal i akuzuari me bateri të madhe dhe na ka ndal dhe i ka thënë kunatit: a je ka sheh se sa shpejtë je duke hecur(vozitur), ndërsa kunati i tha: nuk jam 100 km/h por jam 20 km/h pasi që ishte rruga e keqe, ky nuk na ka lënë me fol, dhe na ka thënë se: tash ju tregojë unë dhe e ka nxjerrur alltinë dhe na ka gjuajtur 3-4 herë, dhe kur kemi ikur ne dhe e ka ndal automjetin kunati, kur e kam kthyer krytë e kam parë të akuzuarin duke ladruar me bateri pas neve. Kam qenë e ulur prapa në automjet pas si pasagjere, pasi kemi që kemi dalur rreth 100 metra na ka dal me bateri, se B. tha se nuk kam qenë duke vozitur shpejtë atëherë ai është nervozuar dhe më shumë dhe ka filluar të shajë dhe në ndërkohë kemi vërejtur se ka nxjerrur një allti, por e di që pasi jemi nisur me automjet i akuzuari ka gjuajtur.

2.2.Provat materiale

2.2.1. Nga Raporti fillestar i incidentit me numër të rastiti datës 18.09.2021, janë konstatuar veprimet hetimore të ndërmarra nga Policia e Kosovës lidhur me rastin e paraqitur.

2.2.2. Nga Raporti i oficerit Blerim Foniqi me numër të rastit i datës 18.09.2021, është konstatuar veprimet hetimore të ndërmarra nga Policia e Kosovës lidhur me rastin e paraqitur nga i dëmtuari B.K. i cili kishte deklarua se rreth orës 20:20 minuta përderisa kishte

qenë duke udhëtuar me automjetin e tij Volvo, ngjyrë e zezë, bashkë me gruan e tij Sh. dhe kunatën V., në rrugën e paasfaltuar në fshatn M., K. e Malishevës, afër një are me pemë të mbjella, një person që kishte qenë afër rrugës me bateri dore i kishte sinjalizuar që të ndaleshin, ku pasi që kishin ndalë automjetin dhe e kishte hapur xhamat e përparme i dyshuari i tensionuar i kishte thënë të dëmtuarit : “pse po vozitë 100 km/h ndërsa i dëmtuari ishte përgjigjur se “ nuk po e drejtoj automjetin me shpejtësi të madhe por me shpejtësi normale, ku i akuzuari kishte filluar që ta fyejë të dëmtuarin ku në ato momente e dëmtuara Sh. e kishte vërejtur të akuzuarin që po e nxirrte një pistoletë nga brezi dhe i kishte bërë titur B. që të lëvizë shpejtë me automjet, ku pasi B. kishte lëvizur shpejtë me automjet në ikje e sipër kishte vërejtur të akuzuarin duke shtënë me pistoletë në drejtim të automjetit të tij. Pas përshkimit të dëmtuarit ishte bërë shikimi i vendit të ngjarjes ku si provë materiale janë gjetur dy gëzhoja, pasi ishte kontaktuar edhe i akuzuari i njëjti kishte pranuar se ka shtënë me armë zjarri-pistoletë por jo në drejtim të dëmtuarve, ku nga i akuzuari është konfiskuar pistoletë si dhe leja valide për armë, po ashtu është kërkuar ndihma mjekësore në QKMF në Malishevë për të dëmtuarën Sh. P. dhe V. K.. Ku është bërë edhe shikimi i automjetit i cili ka qenë i përfshirë në rast por nuk ka pas ndonjë dëmtim eventual nga ndonjë predhë.

2.2.3. Nga Lista e armëve të konfiskuara është konstatuar se leja e armës së leshur nga MPB-ja e emërtuar leje për armë shenjëtarie me datë të skadimit 07.04.2020 përkatësisht i leje e veçantë nr. kartelë..... të lëshuar nga MPB në emër të A. K.

2.2.4. Nga Raporti i vendit të ngjarjes i përpiluar nga PK -Njësia për forenzikë, i datës 17.09.2021 është konstatuar se me datën 17.09.2021, rreth orës 20:30/h pasi që janë njoftuar për rastin që kishte ndodhur në fshatin M., K. Malishevës, dhe në vend të ngjarjes kishin shkuar Njësia e Forenzikës, njësia e krimteknikës, hetuesia dhe dy patrulla policore së bashku me B.K. i cili iu kishte përshkruar ngjarjen se si ka ndodhur, vendi i ngjarjes kishte qenë një rrugë e pa asfaltuar në fshatin M., K Malishevës ku përgjatë kësaj rruge kah ana e djathtë është plantacioni (ara) me pemë të dyshuarit. I dëmtuari e ka përshkruar rastin ku sipas tij i dyshuari ka qenë brenda plantacionit me pemë dhe ai me veturë ka qenë në rrugë dhe se në mes tyre ka qenë një rrjet diku rreth 130-150 cm. Ku janë kërkuar dëshmi në vendin e ngjarjes dhe janë gjetur dy gëzhoja të kalibrit 9 mm në brendësi të plantacionit me pemë që dyshohet të jetë përdorur në rast. Është bërë këqyrja e vendit të ngjarjes, fotografimi dhe mbledhja e dëshmive, është fotografuar vendi ka qenë duke lëvizur me veturë i dëmtuari. Në paralel me stallën që gjendet në anën e majtë të rrugës dhe plantacioni me pemë që gjenden në anën e djathtë të rrugës janë has në brendësi të plantacionit me pemë dy gëzhoja të kalibrit 9 mm që dyshohet të jenë përdorur në rast kah ana e djathtë është plantacioni.

2.2.6. Nga fotoalbumi (1 – 16 foto me ngjyra) i përpiluar nga Policia e Kosovës - Njësia e Forenzikës i datës 17.09.2021, është paraqitur vendi i ngjarjes në fshatin M., Komuna e Malishevës, rrethojat e plantacionit, rruga në të cilën ka kaluar me automjetin e dëmtuarit, automjeti “Volvo”, gëzhojat, si dhe pistoletë së bashku me lejen për armë të shenjëtarisë.

2.2.7. Nga 2 raportet mjekësore të lëshuara nga Dr.Arbenitë Hoti në emër të dëmtuarës Sh. P. dhe V. K., është konstatuar se me datën 17.09.2021 që të dyja kanë kërkuar ndihmë

mjekësore në QKMF në Malishevë ku në raporte është përshkruar gjendja shëndetësore dhe emocionale e tyre si dhe terapia që iu është dhënë.

2.3 Mbrojtja e të akuzuarit

2.3.1 I akuzuari A. K, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë sipas pikës II të aktakuzës ndërsa nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale nga dispozitivi i I-rë i aktakuzës ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se unë nuk e ndiej vetën fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet duke deklaruar se po kam dhënë një deklaratë në Prokurori e di se çka kam deklaruar dhe mbetem pranë asaj deklaratë në tërësi, ka shtuar se arsyeja e ndaljes së automjetit ka qenë me pa se kush është ka vozitë aq shpejtë në atë kohë të vonë, për arsyen se në atë muaj kemi pasur disa vjedhje në fshat dhe i kemi pasur të raportuara në polici dhe si lagje kemi qenë duke bërë roje dhe për atë arsye kam dhënë shenjë që të ndalet, në vendin ku është ndalur dhe prej dajve të vet tek vendi ku është ndalur është 100-150 metra, ku ka dal me një vrull shumë të shpejtë dhe qëllimi ka qenë me e identifikuar dhe me ia tërhequr vërejtjen për mos me vozitë shpejtë, rruga është private, ka qenë e imja por e kam lëshuar për lagjen ku e shfrytëzojë 4 shtëpi, e ka përshkruar momentin e ndalimit kur është afruar në 50 metra e kam paralajmëruar me dritë 3 herë, një herë e kam pasur dritën e gjatë, 2 herë me ndërprerje, edhe është ndalur para meje, ku unë kam qenë i pshtetur në rrjetë, dhe i kam thënë : Hape dritaren, ky në atë moment i kishte pas të hapur dritaren dhe ka qenë afërsia tek rrjeta rreth 50 cm, dhe fjalën e parë më ka thënë : Se kush je ti që më ndale?, unë e kam ndezur baterinë-dritën dhe ja kam kthyer vetës, dhe i kam thënë : Se a po më njeh, pastaj ia kam kthyer baterinë për me e kqyr se kush është dhe kur ia kam drejtuar dritën e kam parë vozitësin dhe një grua përpara dhe sa kanë qenë pas ulur në ulësen e veturës nuk e di, dhe më tha : Ndale baterinë se me të dal ta fus mbrapa, unë i kam thënë ? Në atë nervozë e kam shajtur me nënë, pa e ditur se kush është nuk e kam njohur, dhe sot ndihem keq që ka ndodhur, dhe ky është nisur me vrull ku gurët e zhavorrit në kanë rënë këmbëve, pasi që unë i thash se je duke vozitur shumë shpejtë përmbi 60 km² , pasi duke ikur gurëve të zhavorrit jam vjerrur në rrjetë, dhe në atë moment i kam pasur dy buba të vegjël (qenë), Revolen nuk e kam mbajtur në brezë por e kam pasur qante origjinale për revole dhe e kam mbajtur aty, dhe e kam pasur mbrapa shpinës, ku të njëjtën nënstop e kam mbajtur në krahun e majtë pas shpinës. Pas largimit të veturës unë në atë moment jam larguar nga rrjeta, ka pasur zhavorr që më ka rënë këmbëve, ku është krijuar mjegull prej pluhurit dhe kam vazhduar duke ecur në plantacionin përpyjetë. Në anën e kundërt kah ka shkuar vetura dhe kam vazhduar në drejtim të arrave ku distanca e rrjetës dhe arrave është 8 metra, dhe kam ecur dikund rreth 15-20 metra, një tubë e qeneve mbrapa veturës së tyre dhe mi ka kap njërin prej tyre dhe mi ka sulmuar, kam bërë me elektrik tubës së qenë dhe kam shtënë në ajër dhe në anën e majtë e kemi malin ku nuk bëjnë plumbat qorr dëm dhe kur kam shtënë unë në tubën e qeneve, të dëmtuarit kanë qenë 200 metra duke shkuar teposhtë, janë ndi 3 të shtëna me armë në pjesën e poshtme, unë pas 3-4 sekondave kam shtënë në ajër dhe kam dëshmi mjekun veterinarinë ku të nesërmen i kam dërguar për shërim, ndërsa të dëmtuarit kanë qenë të ndalur në asfalt ku distanca prej dyerve të mija ka qenë 320 metra. Ndërsa në pyetjet e parashtruar nga prokurorja, i njëjti është përgjigjur se është e vërtetë se të njëjtit i kam sinjalizuar me bateri, ku janë ndalur, dhe se i pari i dëmtuari më ka ofenduar me fjalët : Se ta fus baterinë në z.....; se armën e ka ditur nuk ka të drejtë me e mbajtur me vete por të njëjtën e ka mbajtur me vete natën kritike brenda plantacionit të tij, se ka shtënë

në drejtim të kundërt (jo në drejtim kah ka vazhduar automjeti) në ajër 2 herë dhe atë për të larguar qenët pasi që e kishin rrokur në vete bubinë dhe ishin sulmuar mes vete dhe se ka dëshmitarë veterinarin se e dërguar në mjekim qenin e cila nuk ka qenë pasojë e plumbit por e kafshimit dhe për këtë është dashur që të shërohet. Ka shtuar se : E vërteta është se vetura është ndalur 50 cm afër meje, se gëzhojat janë gjetur brenda në plantacion 18 metra në drejtimin e kundërt ndërsa prej vendit të ngjarjes është distanca 18-20 metra. Po është e vërejte pasi që ndihem keq se pse ka ndodhur kjo pasi që jemi kushërinj në mes vete.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë trupi gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se i akuzuari A. K., me dashje ka kryer veprën penale: Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv I dhe II të këtij Aktgjykimi.

4. Elementet e veprave penale

Në nenin 366 paragrafi 1 të KPRK-së, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale e kryen “*Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet*”. Ndërsa, në Ligjin për armët, është parashikuar se për të mbajtur në posedim apo pronësi ndonjë armë, duhet që personi të ketë leje valide të lëshuar nga organi kompetent. Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata, e ka shpallur fajtor të akuzuarin A. K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Në nenin 367 paragrafi 2 të KPRK, është parashikuar se këtë formë të kësaj vepre penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, e kryen “*Kushdo që përdorë armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet*”.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Gjykata lidhur me veprën penale sipas pikës I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ka vlerësuar me shumë kujdes të gjitha provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe ka ardhur në përfundim se nuk duhet t'i falet besimi deklarimit të akuzuarit A.K. të dhënë gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor me të cilën nuk e mohon kryerjen e veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga paragrafi 1, por e mohon mënyrën e kryerjes nga par. 2 të KPRK-së, ku sipas vlerësimit të gjykatës mohimi i kryerjes së veprës penale sipas akuzës është bërë thjeshtë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale lidhur me veprën për të cilën ngarkohet, andaj Gjykata nuk ja fali besimin deklarimit të akuzuarit për shkak se

deklarimi i tillë është në kundërshtim me provat të cilave gjykata ju ka falur besimin si dhe nga deklarata e të dëmtuarëve - dëshmitarëve B. K. dhe Sh. P. të cilët kanë dëshmuar, ku dëshmitari Besim ka deklaruar se kam qenë në vizitë tek daja im në fshatin M., ku kam shkuar së bashku me nënën, bashkëshorten dhe kumatën dhe kam qëndruar rreth 40 minuta dhe kur jam kthyer i akuzuari fillimisht ma ka drejtuar dritën dhe unë jam ndalur për të shikuar se çfarë po dëshiron dhe më është drejtuar me fjalët : Se nuk vozitet në këtë rrugë 100km/h dhe i njëjti i kishte thënë se në këtë rrugë nuk mund të vozitet 100km/h në orë pasi që është rrugë e papërshtatshme-e paasfaltuar dhe i akuzuari iu është drejtuar se tash unë ta tregojë ty se sa kilometra vozitet duke e ofenduar me nënë, ndërsa e dëmtuara tjetër dhe dëshmitarja V., i kishin thënë B.: largohu se është duke e nxjerrur alltinë dhe i njëjti ishte nisur me shpejtësi dhe sipas deklaramit të tij pas 4-5 sekonda ka dëgjuar të shtëna me armë 3 herë dhe kur ka shkuar afër rrugës kryesore është ndalur ndërsa nga ana e bashkëshortes është njoftuar se i njëjti është duke na ndjekur pas, ku këtë e kishin vërejtur në bazë të dritës, për çka gjykata deklarimit të këtij dëshmitari ia fali besimin e plotë, po ashtu nga deklarata e dëshmitares Sh. P.e njëjta ka deklaruar se natën kritike bashkë me bashkëshortin, vjehrrën, kumatën dhe një vajzë 2 vjeçe ka qenë për ngushëllime tek daja i burrit, ku kanë qëndruar rreth një gjysmë ore dhe pasi që dolën e kemi parë të akuzuarin me dritë shumë poshtë prej pemëve dhe na bëri me dritë për me u ndal, ku ne u ndalum dhe i tha B., këqyr sa jeni duke vozitur, ndërsa B. i tha nuk jam duke vozitur 100 km/h por as 20 km/h pasi që është rruga e keqe, ndërsa i akuzuari i tha se: tani unë të tregojë ty se a je duke vozitur 100 km/h, dhe ka filluar duke shajtur tyl farë fjalësh dhe pastaj e ka futur baterinë ndër sjetull dhe e ka nxjerrë alltinë dhe unë kam bërëtitur o B. ik se o ka donë me e nxjerrë alltinë, dhe deri sa kemi dalur në rrugën kryesor ky ka hec dhe baterinë nuk e ka ndal, dhe ka gjuajtur me armë nja 3 herë të njëpasnjëshme dhe i njëjti ka qenë andej telave të plantacionit dhe si kam bërëtitur unë B. ik, ka gjuajtur dhe i akuzuari na ka ndjekur prapa veturës deri në fund të telave duke ngajtur dhe këtë e kam parë pasi që ishte me bateri, ku gjykata dëshmisë së kësaj dëshmitare ia fali besimin e plotë, pasi që deklarata e të njëjtës ka lidhshmëri me deklaratën e dëshmitarit B. K., po ashtu këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitares V. K., e cila ka dëshmuar se kemi qenë në mbrëmje tek dhe kah u kthjem na ka dal i akuzuari me bateri të madhe dhe na ka ndal dhe i ka thënë kumatit: a je ka sheh se sa orë je duke hecur(vozitur), ndërsa kunati i tha: nuk jam 100 km/h por jam 20 km/h pasi që ishte rruga e keqe, ky nuk na ka lënë me fol, dhe na ka thënë se: tash ju tregojë unë dhe e ka nxjerrur alltinë dhe na ka gjuajtur 3-4 herë, dhe kur kemi ikur ne dhe e ka ndal automjetin kunati, kur e kam kthyer krytë e kam parë të akuzuarin duke ladruar me bateri pas neve. Kam qenë e ulur prapa në automjet pas si pasagjere, pasi kemi që kemi dalur rreth 100 metra na ka dal me bateri, se B. tha se nuk kam qenë duke vozitur shpejtë atëherë ai është nervozuar dhe më shumë dhe ka filluar të shajë dhe në ndërkohë kemi vërejtur se ka nxjerrur një allti, por e di që pasi jemi nisur me automjet i akuzuari ka gjuajtur. Po ashtu e njëjta ka dëshmuar se i akuzuari pak pasi jemi larguar na ka nisur me gjuajtur me armë ndërsa sa i përket ndjekjes nga i akuzuari e njëjta ka deklaruar se e kam kuptuar nga dritat pasi që ky kur vraponte lëvizte edhe drita, ky gjykata dëshmisë së kësaj dëshmitare ia ka falur besimin e plotë, për shkak se dëshmia e saj është në harmoni me deklaratën e të dëmtuarëve-dëshmitarëve B. K. dhe Sh. P. Po ashtu gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar edhe në bazë të provave materiale nga raporti i vendit të ngjarjes, ku janë gjetur dy gëzhoja për të cilat veprime i akuzuari nuk i konteston, po ashtu i akuzuari nuk e konteston faktin se i njëjti kas shtënë me armë natën kritike por i njëjti këtë e arsyeton se kinse iu ka gjuajtur qeneve, pasi

që ia kishin sulmuar qenët e tij, mirëpo nga ana e Policisë me rastin e daljes në vend ky fakt nuk është konstatuar, pra deklarimi i të akuzuarit se ju kishin sulmuar qenët nuk është konstatuar si provë përveç deklarimit të tij. Andaj gjykata të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së, pasi që dashja e të akuzuarit ka pasur elemente frikësuese dhe kërcënuese ndaj të dëmtuarve kjo vërtetohet edhe nga dy raportet mjekësore të leshura nga QKMF-ja në Malishevë për të dëmtuarën Sh. P. dhe dëshmitaren V. K., raportet e lëshuara natën kritike, me çka vërtetohet se të njëjtat kanë qenë të frikësuar, ku sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, pretendimet e të akuzuarit janë të pabazuara dhe të supozuara se kinse ka gjuajtur në drejtim të geneve, po ashtu ka potencuar një fakt se i njëjti kishte bërë roje për shkak të vjedhjeve në atë fshat për të cilën gjykata nuk ka ndonjë provë shtuar faktin këtu se i akuzuari të dëmtuarit i ka parë fillimisht duke dalur nga shtëpia e dajës së të dëmtuarit B. (fakt i njohur të cilin e ka ditur edhe i akuzuari se i njëjti ka rast vdekje), andaj Gjykata nuk ia ka falur besimin mbrojtjes së të akuzuarit, pra për Gjykatën, nga provat e lartpërmendura të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilave gjykata iu ka falur besimin nuk është kontestuese fakti se i akuzuari A. K. ka kryer veprën penale të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me veprën penale sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, sa i përket veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së, ka konsideruar se pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, gjatë pranimit të fajësisë trupi gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, si dhe pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij avokatin Agron Kryeziun, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës. Ndërsa meqenëse se i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale nga neni 367 par.2 të KPRK-së, Gjykata nuk e ka shpall vendimin për veprën penale për të cilën e ka pranuar fajësinë pasi që këtë ka vendosur ta bëjë kur të përfundoj procedura edhe ndaj veprës tjetër për të cilën i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë, andaj nuk do vlerësoj provat lidhur me veprën penale nga neni 366 par.1 të KPRK-së (sipas pikës II të aktakuzës) pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë.

5. Vendimet e trupit gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, Gjykata të akuzuarin A. K., e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.2 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, prandaj për këtë ka vendosur që edhe të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit A. K., gjykata rrethanat në kuptim të dispozitave të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se: jeton vet i 20 në familje, bujk i gjendjes së mesme ekonomike, merret me bujqësi, në gjykim ka patuar qëndrim tejet korrekt. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë lidhur me pikën II të akuzës dhe se nuk ka qenë i dënuar më parë për ndonjë veprë penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 46 të KPRK-së dhe këto dënime si të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi

Përveç dënimit kryesor në kuptim të nenit 366 par.3 gjykata ndaj të akuzuarit, ka bërë edhe konfiskimin e një arme (1) pistoletë Loger, model HS9 9mm, me numër serik, prodhim kroat, kalibër 9mm, dy karikatorë, 22 fishekë kalibër 9x19, si objekte të veprës penale.

8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar të cilët kanë deklaruar në shqyrtimin gjyqësor se kërkojnë kompensimin e dëmit, gjykata i ka udhëzuar në kontest civil, duke u bazuar në nenin 463 par.2 të KPP-së.

9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor duke u bazuar në nenin 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.148/21, me datë 10.06.2022

**Zyrtarja Ligjore,
Arbënore Basha**

**Kryetari i Trupit Gjykes- Gjykatësi,
Drilon Haraçia**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.